



Taksa e Pullës
U Pagua

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Notere: **ERNITA HAXHIU**
Nipti: **L61730017A**
Nr. 234 Rep.
Nr. 183 Kol.



KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më datën 21/04/2018 përpara meje Noteres Ernita Haxhiu, Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në Rr. "Kajo Karafili", Tiranë, u paraqitën personalisht, të cilët më kërkuan përpilimin e një Kontrate si më poshtë vijon:

SHITËSI :

Z.Xhevahir Osmani, atësia Hamit, lindur me 10.07.1985 ne Tropoje dhe banues ne Londer, Angli, shtetas britanik, identifikuar me pasaporte britanike **Nr. 508784388**, madhor dhe me zotësi te plota juridike për te vepruar.

Dhe

BLERËSIT :

Z.Kujtim Shtufi, lindur me 01.02.1966 ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar me karte identiteti Nr.**G60201155M**, madhor dhe me zotësi te plota juridike për te vepruar .

Z.Luçiano Koçeku, atësia Mersim, i datëlindjes 25.01.1982, lindur në Bulqize, Diber, banues në Tiranë, madhor me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.**I20125096T**.

Palet e mesiperme me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje kuotash si me poshte :

Shoqëria " LTD Co" shpk, person juridik me NUIS - **L42117004B**, me seli ne Tirane, Rruga e Durrësit, me Administrator **Z. Kujtim Shtufi**.

Shitesi , **Xhevahir Osmani** , është zoterues me 24 % te kapitalit te shoqerise "**LTD Co** " **shpk**, e cila eshte nje shoqeri tregtare shqiptare e regjistruar prane QKR me NIPT - **L42117004B**.

Kapitali i shoqerise eshte 100,000 lekë (njëqind mijë), i zoteruar si me poshte :

- **Luçiano Koçeku**, zoterues i 24 pjesëve, te cilat perfaqesojne 24 % te kapitalit te shoqerise.



- **Ilir Shtufi**, zoterues i 24 pjesëve, te cilat perfaqesojne 24 % te kapitalit te shoqerise.
- **Kujtim Shtufi**, zoterues i 28 pjesëve, te cilat perfaqesojne 28 % te kapitalit te shoqerise.
- **Xhevahir Osmani**, zoterues i 24 pjesëve, te cilat perfaqesojne 24 % te kapitalit te shoqerise.

Objekti i kontrates

Asambleja e ortakeve te shoqerise me vendimin e saj nr.06 date 21/04/2018, bazuar ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare dhe Statutit te Shoqerise, ka vendosur:

- Largimin nga shoqeria te ortakut **Xhevahir Osmani**.
- **Transferimin nepermjet shitjes te 15 % te kapitalit te zoteruar nga ortakut, Xhevahir Osmani**, te ortakut **Z.Kujtim Shtufi**, identifikuar me letërnjoftimin nr.personal G60201155M, **duke u berë Ortak në total me 43% të kuotave** në shoqerine " **LTD Co** " shpk, sipas dokumentacionit të kerkuar me ligj.
- **Transferimin nepermjet shitjes te 9 % te kapitalit te zoteruar nga ortakut, Xhevahir Osmani** te ortakut **Luçiano Koçeku**, identifikuar me letërnjoftimin nr.personal I20125096T, **duke u berë Ortak në total me 33% të kuotave** në shoqerine " **LTD Co** ", sipas dokumentacionit të kerkuar me ligj

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes se 15 % kuotave, te cilat perfaqesojne 15 % te kapitalit te zoteruar nga ortakut **Xhevahir Osmani** dhe qe transferohet nepermjet kesaj kontrate ne favor te ortakut **Kujtim Shtufi** eshte per vleren **600,000 lekë**. (gjashtëqind mijë)

Çmimi i shitjes se 9 % kuotave, te cilat perfaqesojne 9 % te kapitalit te zoteruar nga ortakut **Xhevahir Osmani** dhe qe transferohet nepermjet kesaj kontrate ne favor te ortakut **Luçiano Koçeku** eshte per vleren **300,000 lekë** (treqind mijë).

Në total çmimi i shitjes së 24% te kuotave të ortakut **Xhevahir Osmani** është **900,000 Lekë**. (nenteqind mije)

Bleresit, **Kujtim Shtufi** dhe **Luçiano Koçeku**, kanë paguar sipas paragrafit te mesiperme plotesisht çmimin e shitjes në favor të shitësit, **Xhevahir Osmani**, dhe shitesi deklaroi se e ka marre çmimin e plote te shitjes dhe nuk ka asnje pretendim.



Garancite

Shitesi deklaroi dhe garanton se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotave qe po transferohen nepermjet kesaj kontrate dhe se ato jane te lira nga çdo barre apo pretendim tjeter ligjor. Në bazë të informacionit të lëshuar nga RBS, kuotat rezultojne pa barrë siguruese.

Heqje dore nga te drejtat dhe detyrimet

Shitesi deklaroi nen pergjegjesine e tij personale, se heq dore nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i takojne përkatësisht mbi 24 % te kuotave te zoteruara prej tij ne shoqerine " **LTD Co** " shpk.

Te ndryshme

Pas realizimit te ketij transferimi me nenshkrimin e kesaj kontrate Bleresit, **Kujtim Shtufi** dhe **Luçiano Koçeku**, behen pronare te ligjshem, përkatësisht **Z. Kujtim Shtufi** i 43 % te kuotave te kapitalit te shoqerise, **Z. Luçiano Koçeku** i 33% te kuotave te kapitalit te shoqerise ndersa shitesi zhvishet teresisht nga e drejta e pronesise mbi keto kuota dhe largohet nga shoqeria " **LTD Co** " shpk.

U Porositën Palët që një Kopje të kesaj kontrate ta dërgojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit .

Kjo kontrate u hartua ne kater ekzemplare me vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe palet deklaruan se jane dakort me sa me siper, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nenshkruan regullisht perpara meje dhe une noteri, e vertetoj ate sipas ligjit.

PALET:

SHITËSI

Xhevahir Osmani

XHEVAHIR OSMANI

BLERËSI

Kujtim Shtufi

KUJTIM SHTUFI

Luçiano Koçeku

Luçiano Koçeku

**NOTERE
ERNITA HAXHIU**

Ernita Haxhiu